

GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E SOCIOLINGUISTIKËS SHQIPTARE

STATE AND PROSPECT OF ALBANIAN SOCIOLINGUISTICS

Mustafa IBRAHIMI

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Universiteti i Evropës Juglindore
Tetovë, Maqedoni

E-mail: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

Përmbledhje

Që prej viteve 1964 e më vonë, edhe në sociolinguistikën shqiptare u përcollën tema të cilat ishin pjesë e një orientimi e programi të ri gjuhësor. Sociolinguistika jonë filloi të thithë nga ky potencial që në nëntor të vitit 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Megjithatë, edhe pse gjuhësia shqiptare është e gjerë, ende është e pashtuar mirë.

Duke ndjekur me vëmendje veprimtarinë e dijetarëve shqiptarë, me botimet dhe shkrimet e shumta ata u bënë prijës të prurjeve teorike e të dhënave prej të folmeve shqiptare, ballkanike e më gjerë, duke mundësuar që sociolinguistika si shkencë të degëzohet në disa fusha tematike interesimi.

Trevat që pasuruan laboratorin gjuhësor shqiptar me mënyra të foluri të larmishme janë zonat nga mbarë trevat shqiptare si: diaspora arbëreshe, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Lugina e Presheves etj.

Megjithatë në kushtet e një shqipeje të pambrojtur si duhet nga institucionet, sociolinguistika nuk arriti të paraqitet si disiplinë që sot e do koha të arrijë t'i mbulojë gjerë dhe thellë problemet gjuhësore që ka shqipja. Fillimi i vërtetë i sociolinguistikës shqiptare, mund të pritet atëherë kur do të merren aktivitete linguistike të ngjashme si në SHBA dhe Evropë, kur do fillojnë të paraqiten përmbledhjet e punimeve, monografitë, veprat sintetike, të mbahen konferencat shkencore, të botohen revista dedikuar posaçërisht problematikës sociolinguistike etj.

Abstract

Since 1964 and on, the Albanian sociolinguistics included topics which were part of a new language orientation and program. Our sociolinguistics began to absorb from this capacity since September 1972, at the Congress of the Albanian Language Orthography. Although quite

broad, the Albanian linguistics has not yet been explored.

Tracking carefully the activity of Albanian scholars, publishing numerous writings as well as contribution to the theory and the data of the Albanian and the Balkan's speech have enabled the Albanian sociolinguistic to split in several thematic branches of interests.

Places which enriched the Albanian linguistic laboratory by various manners of speech are the entire Albanian populated areas such as: the arbëresh diaspora, Albania, Kosova, Macedonia, Montenegro and the valley of Presheva.

However, in circumstances of an unprotected Albanian language by the institutions, the sociolinguistic did not manage to appear as a discipline that nowadays life requires and to cover widely all the Albanian linguistic problems. The actual beginning of the Albanian sociolinguistics could be expected only when linguistic activities such as those in the US and Europe, will be undertaken as well as when scientific conferences will be held, or publish monographs, synthetic masterpieces, magazines specifically dedicated to sociolinguistic matters.

Fjalët kyç: Sociolinguistika shqip-tare, gjendja, faktorë mikro dhe makro-sociolinguistike, perspektiva.

Key-words: Albanian Sociolinguistics, state, macro and micro sociolinguistic factors, prospect.

1. Hyrje

Që nga kohët e lashta ka ekzistuar ideja që gjuha ka një histori të sajën. P.sh. qysh në kohën romake ka pasur sprova për histori të gjuhëve, por siç do të reagonte edhe F. De Sosyri, gjuhësia historike merrej tepër pak me raportin ndërmjet pjesëve të ndryshme të sistemit gjuhësor. Interesi i tyre ishte në planin kombëtar, ndoshta edhe nacionalist, por sigurisht jo në planin shoqëror. Ata studionin historinë e brendshme të gjuhëve, historinë e strukturës së tyre, duke mos treguar interes për larminë apo llojshmërinë (varietetet) brenda së njëjtës gjuhë, të folur nga grupe të ndryshme shoqërore (Shkurtaj, 2003:11). Pra edhe pse filozofët, kritikët, historianët etj. kanë treguar interes të madh për gjuhën dhe rolin e saj në gjirin e kulturës në përgjithësi, megjithatë mbetej gjithnjë një boshllëk ndërmjet disiplinave të ndryshme, ndërmjet historisë, gjuhësisë dhe sociologjisë (përfshi këtu edhe antropologjinë sociale). Ky boshllëk mund dhe duhet të plotësohet nga historia shoqërore e gjuhës. (Burke, 1990:3-31). Ky lloj interesimi, është tipik për sociolinguistikën, si shkencë bashkëkohore, e cila u përkufizua dhe u mëkëmb si disiplinë e veçantë aty nga gjysma e viteve '50 në SHBA e gjetkë, porse zhvillimi i saj lulëzoi në dekadën e shtatë të shek. XX. Vetëdija rreth vlerës shoqërore të larmisë gjuhësore nuk është tërësisht e kohëve të reja.

Gjithandej, në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë, qysh në shek. XV ka pasur njerëz që gjuhën e kanë quajtur “*dukuri thelbësore shoqërore*” dhe kanë bërë edhe vëzhgime me karakter sociolinguistik shumë të mprehtë. P.sh. në Itali, fiorentinasi Vincenzo Borgini kishte vënë re dhe synonte të shpjegonte arkaizmat tipike të të folurit të katundarëve (Burke, 1990:5). Një vetëdije sociolinguistike të ngjashme mund të gjejmë që nga dijetarët dhe filozofët e vjetër grekë, diskutimet për këtë çështje kanë vazhduar nëpër Romën e lashtë, pastaj në empirizmin anglez, racionalizmin francez etj. deri te filozofët dhe semilogët amerikanë si Ç.S. Pers (C.S. Peirce) dhe Ç. Moris (C. Morris) (Radovanoviq, 1979:95). Kontribut mjaft të madh kanë dhënë edhe evropianët duke filluar me veprat e Shekspir, të Molierit, Goldonit etj., si dhe në shumë romane të shek. XVIII, qysh nga Zhorzh Elioti e Lev Tolstoi deri te lingvistët dhe semilogët e shek. XX, si F. De Sosyri, A. Meje (A. Meillet), A. Martine (A. Martinet) etj. Të gjithë këta u orvatën t’i studiojnë raportet dhe veprimet midis dukurive gjuhësore dhe shoqërore, duke u bazuar në studimet lidhur me gjuhën individuale në një shoqëri (mikrosociolinguistika), si dhe në gjuhën e një shoqërie ose pjesëve të saj (makrosociolinguistika). Në punën e saj sociolinguistika më tepër interesohet për përdorimin e gjuhës sesa njohuritë teorike të saj.

2. Formulimi i problemit

2.1. Fillimi i kërkimeve në fushën e sociolinguistikës botërore

Fillimi i vërtetë, në kuptimin e shkruar, mund të merren ato vite dhe ato aktivitete linguistike në SHBA dhe Evropë kur u paraqitën përmbledhjet e punimeve, monografitë, veprat sintetike, konferencat shkencore, revistat dedikuar posaçërisht problematikës sociolinguistike. Zhvillimin e saj më të madh e kemi në fund të viteve ’60 deri në fillim të viteve ’70, kur ajo në fakt u konsolidua si një drejtim i ri e me peshë i kërkimeve dhe e u botuan shumë doracakë universitarë, studime e kërkime teoriko-praktike në këtë fushë. Si të tillë konsiderohen librat mjaft të njohur si: *The Ethnography of Communication*, Ed. J.J. Gumperz, D. Hymes, *American Anthropologist*, Vol. 66, N. 6, Part II, Washington, D.C., 1964. (Radovanoviq, 1979:111); *Language in Culture and Society. A Reader in Linguistics and Anthropology*, Ed. D. Hymes, New York-Evanston-London, 1964 etj. Për të përmendur janë, sidomos tekstet e përgjithshme të një numri autorësh me famë, si: Burling (1970), Praid (Pride) (1971), Fishman (1972), Robinson (1972), Ditmar (1973), Tridgill (1974), Plat (1975), Bell (1976), Verdhog (Wardhaugh) (1976), Hudson (1980), Berruto (1975) etj.

Sociolinguistika sot është shumë më e pranueshme, falë një mjeti shumë të rëndësishëm studimi, *Encyclo-*

pedia of Language and Linguistics që i kushton shumë vend sociolinguistikës, dhe falë burimeve të tjera të rëndësishme, midis të cilëve më pak i vëllimshmi *International Encyclopedia of Linguistics* dhe *Principles of Linguistics Change: Internal Factors* i Labovit. Këtu duhet përmendur edhe një sasi manualesh të mrekullueshme, si: Hudson, Fasold, Holms, Wardhnaugh etj. Një mjet i rëndësishëm është edhe interneti, ku mund të realizohen shumë projekte studimore (Hudson, 2002:10). Në shumë universitete të Amerikës dhe Evropës sociolinguistika mësohet si një lëndë kryesore në degët e gjuhësisë dhe problemeve të sociolinguistikës u kush-tohen konferenca e kongrese shkencore ndërkombëtare, si dhe ka revista të specializuara enkas, siç janë dy të tilla të mëdha që botohen në gjuhën angleze: *Language in Society* dhe *International Journal of the Sociology of Language* (Shkurtaj, 2003:22).

2.2. Lindja dhe zhvillimi i sociolinguistikës shqiptare

Gjuhësia shqiptare është e gjerë dhe ende e pashtuar mirë duke ofruar studime empirike dhe teorike edhe në fushën e sociolinguistikës. Ide të hershme për një qëndrim a konceptim sociolinguistik të gjuhës ka pasur edhe në radhët e gjuhëtarëve shqiptarë. Këtu mund të përmendim disa ide të At Justin Rotës rreth mundësisë që ka njeriu për ta “dredhë gjuhën”

sipas rastit e bashkëbiseduesit (Rrota, 1931:121-133). Prej viteve 1964 e më vonë, edhe në sociolinguistikën shqiptare u përcollën tema të cilat ishin pjesë e një orientimi e programi të ri gjuhësor. Sociolinguistika jonë filloi të thith nga ky potencial që në nëntor të vitit 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ku prof. E. Çabej mban kumtesën me titull: “*Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*”. Që pikërisht koha kur në Shqipëri pat filluar një proces industrializimi. Çabej do të jap edhe një kontribut tjetër, *Mbi lidhjen e gjuhës dhe seksit në të ashtuquajturën prej tij “ të folët e grave*”. (Çabej 1978: IV). Megjithëse politika gjuhësore e viteve të parapluralizmit, këto punime i trajtonte si “qëndrim idealist” (Shkurtaj, Gj. 1998:87).

Në veprat e më vonshme ndeshim prurje të gjuhësisë moderne që kanë të bëjnë me identitetin fizik, psikologjik, gjeografik, etnik, shoqëror, kontekstual. stilistik të folësit (Ismajli, 2001:241-248); ballafaqohemi me tezat se në kushtet e dy e shumëgjuhësisë për shqipen letrare nevojitet koncepti i gjuhës së hapur dhe dinamike (Lloshi, 2001:263-274); por edhe pasurimi i identitetit kombëtar në këtë botë të globalizmit (Qosja, 2003:36-41); njohim hulumtuesit që të dhënat e të folmeve e të folësve shqiptarë u dhanë mundësinë të përcaktojnë e të shpjegojnë pikëtakimin midis izoglosave e izoergeve; takojmë dijetarët që

në shpjegimin e strukturave gjuhësore dhe në trajtimin e lëndës folklorike, etnografike marrin parasysh faktorë gjuhësorë e jogjuhësorë. Në hullinë e këtyre prurjeve, lindën studiuesit e zëshëm e të rinj, si R. Ismajli, Gj. Shkurta, Sh. Sejdiu, R. Memushaj, M. Ymeri, J. Shpuza, A. Ballhysa, B. Rugova, A. Haxhi, A. Doko etj. (Lamaj, 2005:429). Me këtë edhe gjuhësia shqiptare e pati "orën e saj fatlume" kur mund ta rrokte e ta tejçonte këtë disiplinë, asokohe ende të re në botë.

Shtjellimi më serioz i lëndës etnosociogjuhësore nisi me kursin teorik të viteve '93-94 në universitetet shqiptare, gjeti trajtim shumëplanësh në simpoziumin shkencor "Probleme të studimeve sociolinguistike shqiptare" (prill 1995) të Universitetit të Tiranës, ku jo vetëm u përshkrua rruga e kalimit nga gjeografia gjuhësore tek dialektologjia urbane (Shkurta, 1996), por u trajtuan edhe gjendja shoqërore e gruas, sjellja e të folurit të saj (Asenova, 1996/1), problemet e alfabetizimit dhe standartizimit të gjuhëve (Memushaj, 1996/1), prirjet endocentrike të shkencave shoqërore (Rrokaj, 1995), norma gjuhësore etj. e erdhi kështu në mjediset studentore teksti universitar "Sociolinguistika", që u ribotua disa herë (Shkurta, 1996b).

Në këtë hulli u zhvillua dhe sesioni shkencor i Universitetit të Gjirokastrës, i cili mori në shqyrtim dukurinë e bilinguizmit. Në këtë veprimtari shkencore studiuesit shqiptarë dhe ata të huaj sollën në kumtesat e

tyre përvojën e arsimimit e të edukimit gjuhësor në mjedisin arbëresh e në shkollat e pakicës greke (shih *Kërkime universitare* 2001/5), sipas tri realiteteve: autoritetit shtetëror (legjislacioni), mësuesit (tekstet) dhe bashkësisë së nxënësve.

Realitetet antropologjike e etnosociolinguistike janë parashtruar e shqyrtuar edhe në seanca të veçanta apo si pjesë përbërëse e trajtimeve të larmishme gjuhësore edhe në *Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, i cili është zhvilluar e zhvillohet në Prishtinë e në Tiranë. Vlen të përmendet, p.sh. Seminari XVIII-të Ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare, ku një seancë e veçantë iu kushtua problemeve të sociolinguistikës: ligjërimit rinor, normës sociolinguistike në shtyp e radiotelevizion, funksionit të gjuhës në masmedia etj.

Sociolinguistika shqiptare lindi për të mpiksur në një truall të vetëm tharmin e strukturalizmit në gjuhësi dhe vëmendjen gjithnjë në rritje të sociologëve e antropologëve lidhur me komunikimin njerëzor.

2.3. Për një klasifikim të temave sociolinguistike shqiptare

Në SHBA, sociolinguistika pati një zhvillim të madh, para së gjithash duke iu falënderuar botimeve dhe shkrimeve të shumta dhe të ndryshme jo vetëm nga kjo fushë, por edhe nga ato jo gjuhësore. Kjo mundësoi që so-

ciolinguistika si shkencë të degëzohet në disa fusha tematike të interesimit, por për fat të keq edhe më tej hasim mospajtime rreth terminologjisë dhe metodologjisë (vlen të përmenden klasifikimet e preokupimeve dhe përcaktimeve sociolinguistike). Një klasifikim të tillë është edhe ai i J.V. Neustupni, i cili i ndan autorët sipas fushave të interesimit. (Radovanović, 1975:112)

Duke ndjekur me vëmendje veprimtarinë e dijetarëve të sipërpërmendur shqiptarë, me botimet dhe shkrimet e shumta si prijës të prurjeve teorike e të dhënave prej të folmeve shqiptare, ballkanike e më gjerë, mund të bëjmë edhe ne një klasifikim të tillë, sipas fushave të interesimit. Vlen të përmendim se Shqipëria, Kosova, Malësia e Madhe, Labëria, Mokrra, Kurbini, Maqedonia e diaspora arbëreshe janë trevat që pasuruan laboratorin gjuhësor shqiptar me mënyra të foluri të larmishme.

1. Në grupin e parë përfshihen autorët të cilët aktivitetet e tyre i drejtojnë në fushën e ashtuquajtur "dialektologjia urbane dhe sociale", që pa mëdyshje paraqet një rast interesant për kundrimin sociolinguistik. Ash-tu, si në shumë vende të botës, edhe në gjuhësinë shqiptare, sociolinguistika ka marrë zhvillimin si një vijim i studimeve dialektologjike, sidomos si një kalim i këtyre kërkimeve nga interesimi kryesisht për gjeografinë gjuhësore apo për dialektet dhe shtri-

rjen hapësinore të dukurive a tipareve të tyre (dialektologia "rurale") në një interesim për larminë dhe variacionet gjuhësore brenda qendrave të mëdha qytetare (dialektologjia urbane) (Shkurtaj, 2003:15).

Në hulumtimet shqiptare për sociolinguistikën u rrekën tema, para së gjithash tek studimi i nëndialekteve e dialekteve krahinore dhe ndërkrahinore apo diçka lidhur me të folmet e diasporës arbëreshe. Kjo për afro 30 vjet radhazi, derisa mbërritëm në fund të viteve '80, kur filloi hapja e shoqërisë, kulturës dhe gjuhës shqipe ndaj botës (shtoji kësaj edhe valët pasuese të emigracionit masiv dhe atë të pandërprerë me natyrë individuale).

Ato janë burim për shqyrtime të këtij lloji, falë larmisë që paraqesin folësit e tyre në veshje, në zakonet e dasmës, në rite e doke, e në radhë të parë në mënyrën e të folurit, në ndryshimet fonetike e gramatikore. Gjatë kësaj periudhe ka pasur disa sprova jo të parëndësishme në këtë lëmë, siç janë studimet: *Për të folmet shoqërore* (Haxhihasani, 1996/1, 2, 3); *Disa shqyrtime rreth zhvillimeve e ndryshimit të të folmeve popullore në disa zona të Malësisë së Madhe* (Shkurtaj, 1969:162); *E folmja e qytetit të Lezhës* (Shkurtaj, 1981:155-163); *E folmja e qytetit të Elbasanit* (Gosturani, 1980); *E folmja e qytetit të Shkodrës në dy sisteme fonologjike* (Beci, 1976, 1995). *Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës* (Shkurtaj, 2000:142); *Rreth ndryshimeve në fshatin*

e sotëm të Veriut (Shkurtaaj, 1969:162).

U trajtua edhe gjendja shoqërore e gruas, sjellja e të folurit të saj, siç janë punimet: *Gruaja monolingue në Ballkan* (Asenova, 1996/1); *Dallimet gjuhësore midis gjinive në të folmet shqipe në Maqedoni* (Ibrahimi, 2006: 9-115).

2. Në grupin e dytë të studiuesve përfshihen ata që përcaktohen për hulumtimet e interaksionit shoqëro-gjuhësor dhe korrelacioneve përkatëse midis raporteve dhe strukturave shoqërore, kulturore dhe gjuhësore, kuptohet duke përfshi këtu edhe ndikimet gjuhësore. Sprova e kërkime të suksesshme rreth gjendjes së dygjuhësisë apo edhe për probleme të tjera që hyjnë në qerthullin e interesimeve të mirëfillta sociolinguistike ka pasur para së gjithash për ato të diasporës arbëreshe në Itali, ndërsa në viset tjera shqiptare deri vonë kërkimet kanë qenë të pakta si numër, por vrojtime dhe kërkime etno e sociogjuhësore ka pasur edhe për bashkësitë shqiptare e joshqiptare në Republikën e Shqipërisë, Kosovë e në Maqedoni. Në këto hapësira gjeografike shqipja shfaqet si gjuhë në kontakt me statusin e një gjuhe të parë a të dytë. Sipas këtij vështrimi u trajtuan raportet e shqipes me greqishten, bullgarishten, serbokroatishen, maqedonishten, italishten, turqishten etj. Siç janë punimet: *Gjuha, ndikimet dhe ndryshimet, në Standarde dhe identitete* (Ismajli, 2003:136); *Bilinguizmi dialektor* (Shkurtaaj, 1984: SF/2); *Bilinguizmi*

te fëmijët shqiptarë në mërgim (Ibrahimi, 2005-a); *Shumëgjuhësia si segment kryesor i multikulturalizmit* (Ibrahimi, 2005-b:103-114) etj.

3. Grupin e tretë e përfaqësojnë sociolinguistët të cilët fokusimin e tyre e kanë drejtuar në: problematikën e politikës gjuhësore, planifikimin gjuhësor për standardizimin gjuhësor etj. Pa dyshim grupi më i madh dhe më i rëndësishëm në sociolinguistikën shqiptare. Janë shqyrtuar temat si problemet e alfabetizimit dhe standartizimit të gjuhëve, është trajtuar mbarrëvajtja e varietetit standard ndër shkollarët shqiptarë, si: *Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës* (Memushaj, 1996/1); *Gjuha zyrtare në shtetet shumëgjuhësore të botës dhe aplikimi i tyre në Maqedoni* (Ibrahimi, 2003:33-40); *Shqipja standarde dhe shkolla* (Ismajli, 2003b:159); *Gjuha shqipe dhe trysnia shoqërore* (Shkurtaaj, 1998b:48); *Shkolla dhe shqipja letrare* (Shkurtaaj-Memushaj, 1998c/1-4); *Fjalori i rënduar i medias* (Shkurtaaj, 2002b) etj.

4. Si orientim i katërt dhe i veçantë u krijua edhe ashtuquajtura *etnografia e komunikimit*, preokupimi kryesor i të cilëve ka të bëjë me pyetjen, definimin, statusin, funksionin dhe strukturën e kompetencës së komunikimit dhe marrja me pyetjen rreth përdorimit të asaj kompetence, gjegjësisht aspektet pragmatike të përdorimit të gjuhës, rregullat rreth organizimit të aktit folës dhe ngjarjes, gjegjësisht komponentëve të tyre.

Në hapësirën e tyre të punës, dijetarët shqiptarë kanë marrë role që lidhen jo vetëm me gjykimin e gjuhëtarit e sociolinguistit, por edhe me atë të etnologut. Si pasojë e një pune pasionante e të organizuar, është mbledhur *një lëndë e begatë eufemistike*. Eufemizmat janë trajtuar fillimisht nga mjeshtri i shqipes, Çabej, por pas viteve 90 u bënë objekt gjykimi i gjuhëtarëve e dashamirëve të gurrës popullore shqipe, si: *Pasqyrimi i eufemizmeve në letërsinë gojore dhe artistike* (Osmani-Pepa, 1995-1996); *Et-nolinguistika ne veprën Çabejt* (Zhurga, 2003); *Disa eufemizma të shqipes* (Çabej, 1976:17); *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve* (Shpuza, 1998); *Sisteme e struktura, raporte* (Sejdiu, 2002); *Rreth normave të sjelljes gjuhësore dhe kritereve të gojtarisë në folklorin e viseve të Veriut* (Zhugra, 2001); *Strukturat e këngëve të kreshnikëve, vlerat e antroponimeve në poemën "Lahuta e Malësisë"* (Shih më gjerë artikujt e Gj.Shkurtajt), etj.

Një nga tiparet e strukturës së sotme shoqërore evropiane është *veçimi i studentëve si grup më vete*. Sociolinguistika e vlerëson zhargonin studentor apo ligjërimin rinor si "varietet në raport me përdoruesin (Coveri, 1992:60); *Ligjërimi rinor i studentëve të viteve '90* (Ymeri, 1999: 275-282); *Gjuha e fshehtë e të rinjve të Prishtinës* (Rugova, 1999:364-369). Nga këto studime është arritur në përfundimin se ligjërimi studentor me prirjet narciziste (të admirimit për vetveten) e kriptike (ndjenja e maskimit), lu-

dike (konsiderimi komunikimit si lojë), shpreh lidhjet midis realitetit dhe identitetit me procedime retorike në nivelin e tropeve, me anë të fjalëformimit të shpejtë etj. (Lamaj, 2005:437).

Nuk pretenduam t'i japim të gjitha publikimet shqiptare me temë sociolinguistike, sepse një gjë e tillë është e pamundshme në mungesë të një bibliografie të sociolinguistikës shqiptare. Vlen të përmendet se në hapësirën ish-jugosllave për katër dekada rresht (1967-2007) për ta plotësuar Bibliografinë sociolinguistike evropiane, rregullisht janë dërguar botimet e ndryshme nga ish-hapësirat jugosllave. Për këtë periudhë janë përfshi 550 njësi me rreth 220 autorë (Bugarski, 2002: 189-194). Nga e tërë kjo, vetëm dy punime ishin me temë shqiptare: Isa Zymberi, *Albanian in Yugoslavia* (Bugarski / Hawkesworth, 1992:130-139); Fridman, Victor A.: *Dialect variation and questions of standardization in Macedonia: Macedonian, Albanian and Romany* (Fridman 1993:7-35).

3. Zgjidhja e problemit

Kërkimet e ardhshme në fushën e sociolinguistikës shqiptare

Meqë zbatimi i sociolinguistikës te përdoruesit e shqipes synon të emancipojë gjuhësisht, u shërbejnë sakaq edhe planifikuesve të gjuhës me qëllim që të garantohet mbarëvajtja

dhe zhvillimi i gjuhës së njësuar. Si pas kësaj, planifikimi i gjuhës duhet të kalojë nëpër tri etapa: 1) Rilevon dhe përshkruan gjendjet konkrete gjuhësore të stadeve sociokulturore; 2) Zbulon faktorët kryesorë që përcaktojnë marrëdhëniet gjuhë-bashkësi shoqërore; 3) Tipizon modelin rregullator, pas të cilit shoqëria përçon, ndryshon dhe prodhon gjuhën (Shamku, 2005:443)

Një kthesë në mënyrën se si dhe për çfarë shqiptarët po e përdorin gjuhën, ndodhi pas rënies së mureve ideologjike kur u vu re binomi gjuhë shqipe-shoqëri shqiptare. Kthesa e sipërthënë e ka zanafillën në migrimet e mëdha të jashtme dhe të brendshme, të shkaktuara qoftë nga modeli i ri i zhvillimit social-ekonomik, ashtu edhe ngaqë sot lëvizja demografike nuk pengohet më. Si rezultat i kësaj paraqitet braktisje e zonave të tëra, përmbysje të fuqishme të strukturave demografike të vendit, përshtjellime të forta në etnokulturat e veçanta, në zakonet apo mënyrën e të menduarit dhe për rrjedhim shfaqjen e një dinamizmi social të theksuar, me gjithë efektet anësore që ai sjell. Edhe migrimi i brendshëm në distanca ose hapësira të vogla, si dyndja ndër qytete e banorëve të fshatit, apo e banorëve të qendrave me tregues ekonomikë më të ulët drejt qendrave më të begata; këto lëvizje të fundit janë frymëmarrje të domosdoshme për gjuhën, meqë në trajtën e shkëmbimeve dhe integri-

meve çojnë drejt një lloji nivelimi të të folmeve lokale. Studimet e ardhshme duhet të fokusohen në studimet e tyre të thelluara duke e vendosur Standardin Pritës në kontakt të vazhduar me variantet gjuhësore, të cilat, sigurisht, përveç dialektizmave të panumërta, përmbajnë edhe fjalë të shumta e të nevojshme, që pragmatizmi i jetës urbane i ka mpirë, i ka zëvendësuar me huazime ose i ka bërë të duken si të panevojshme.

Në repertorin e temave që mund të jenë objekt hulumtimi në sociolinguistikën shqiptare në të ardhmen, mund të përfshihen edhe tema tjera të ngjashme, si: *identiteti social i folësit; identiteti social i dëgjuesit në procesin e komunikimit; mjedisi shoqëror në të cilin flitet; analiza sinkronike dhe diakronike e dialekteve sociale; vlerësimet e ndryshme sociale që folësit japin për sjelljen gjuhësore; entiteti i variacionit gjuhësor; mundësitë e zbatimit të kërkimit sociolinguistik; zhvillimi i sociolinguistikës në gjuhësinë shqiptare etj; çështja e planifikimit të gjuhës, gjuha dhe identiteti, gjuha dhe ndërgjegjja kombëtare; identifikimi gjuhësor, nacionalizmi gjuhësor; ndikimi i planifikimit gjuhësor në identitetin etnik; aspektet ndërkombëtare të planifikimit gjuhësor; ndikimet e gjeneratave në ndryshimet gjuhësore; bilinguizmi dhe diglosia në shoqëritë shumënacionale etj.* Duhet theksuar se këta tema në të cilat janë përfshirë faktorë mikro dhe makro-sociolinguistik nuk kanë vlerë të njëjtë teorike për t'u zbatuar në të gjitha hapësirat shqiptare, megjithatë

disa nga këto tema shumë lehtë mund të përshtaten me mjediset tona shoqërore.

Përfundime

Rezultatet e deritashme nga hulumtimet sociolinguistike, edhe më tutje janë parciais. Në institucionet tona diçka po botohet, por vështirë të gjejë vend pohimi se kjo disiplinë e ka kaluar pragun e rëndë të shqipes, pjesa më e madhe e tyre është para nesh. Kjo parashtrohet nevojën për t'u njohur me hulumtimet më të reja nga fusha e sociolinguistikës në suaza botërore, dhe të shërbehemi me përvojën duke i vërejtur anët pozitive dhe negative të hulumtimeve të tilla. Sipas këtij mëtimi, në artikujt dhe librat shkencorë të viteve të ardhshme, kërkohet një formim më i mirë gjuhësor prej zyrtarëve e pushtetarëve, gazetarëve, medias elektronike e të shkruar.

Meqë në kushtet e një shqipeje të pambrojtur si duhet nga institucionet e lartpërmendura, sociolinguistika nuk arriti të paraqitet si disiplinë që sot e do kohë dhe të arrijë t'i mbulojë gjerë dhe thellë problemet gjuhësore që ka shqipja. Megjithatë me metodologjinë e saj të studimit sinkronik *shkak-pasojë*, hulumtimet e ardhshme duhet të fokusohen që me sukses t'u paraprijë proceseve e dukurive gjuhësore në vijim. Kjo është një nga mënyrat që hulumtimet sociolinguistike të kyçen në përpjekjet e përbashkëta të gjuhëtarëve dhe forcave tjera

progresive të shoqërisë sonë shqiptare për ta realizuar pluralizmin gjuhësor, i cili nuk pranon asnjë hierarki midis gjuhës dhe kulturës.

Fillimi i vërtetë i sociolinguistikës shqiptare, në kuptimin e shkruar do të bëhet atëherë kur do të merren aktivitete linguistike të ngjashme si në SHBA dhe Evropë, kur do fillojnë të paraqiten përmbledhjet e punimeve, monografitë, veprat sintetike, të mbahen konferencat shkencore, të botohen revistat dedikuar posaçërisht problematikës sociolinguistike etj.

Menjëherë duhet të fillohet me hartimin e bibliografisë sociolinguistike shqiptare, si për nevojat tona ashtu edhe për bibliografinë ndërkombëtare. Gjithsesi do të hasen shumë vështirësi lidhur me natyrën e përmbajtjes, duke ditur se sociolinguistika në gjirin e vet përfshin shumë fusha heterogjene dhe difuze. Vallë do të përfshihen vetëm ato punime me përmbajtje të pastër sociolinguistike, apo edhe ato punime ku përmenden disa komponentë të tilla, duhet të merren njerëz profesional dhe institucione përkatëse. Kjo erë për gjuhësinë shqiptare mund të jetë era e mbarë e sociolinguistikës.

Bibliografi

- Asenova, P. (1996) Gruaja monolingue në Ballkan, në *Studime albanologjike*, 1.
- Beci, B. (1976,1995). *E folmja e qytetit të Shkodrës në dy sisteme fonologjike*. Tiranë.

- Bugarski R. (2002). *Lica jezika*. Beograd, Bigz.
- Bugarski, R. / Hawkesworth, C. (eds) (1992). *Language Planing in Yugoslavia*. Columbus, Ohio: Slavica Publishers.
- Burke, P. (1990). *Lingua, societa' e storia*.
- Çabej, E. (1976) Disa eufemizma të shqipes, në *Studime gjuhësore*, IV, 17, Prishtinë.
- Coveri, L. (1992) *Gli studi in Italia: lin-guaggio giovanile degli Anni Novanta*, 60.
- Fridman, V. (1993). Dialect variation and questions of standardization in Macedonia: Macedonian, Albanian and Romany. *Zbornik Matice srpske za filologiju i linguistiku*. Novi Sad.
- Gosturani, Gj. (1980) *E folmja e qytetit të Elbasanit*. Tiranë.
- Haxhihasani, Q. (1964). Për të folmet shoqërore. *Studime Filologjike*. Tiranë, 1. 2. 3.
- Hudson, A. R. (2002). *Sociolinguistika*. Tiranë, Dituria.
- Ibrahimi, M (2003). Gjuha zyrtare në shtetet shumëgjuhësore të botës dhe aplikimi i tyre në Maqedoni. *Interpretime dhe studime gjuhësore*. Shkup, Interlingua.
- Ibrahimi, M. (2005a). Multilingualism as the Main Segment of Multiculturalism. *Multiculturalism in Macedonia: an emerging model*. Skopje, Soros, 103-114.
- Ibrahimi, M. (2005b). *Bilinguizmi te fëmijët shqiptarë në mërgim*. Simpozium ndërkombëtar me temë "Emigracioni prej fillimi deri sot" Strugë 2005. Shkup, Interlingua.
- Ibrahimi, M. - Xhaferi H. (2006). *Dallimet gjuhësore midis gjinive dhe figura e gruas në poezinë popullore*. Tetovë, UEJL.
- Ismajli, R. (2002). Statusi, realitetet sociolinguistike, identiteti... "Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", gusht 2001. Prishtinë, 241-248.
- Ismajli, R. (2003a) Gjuha, ndikimet dhe ndryshimet, në *Standarde dhe identitete*. Prishtinë 136.
- Ismajli, R. (2003b) Shqipja standarde dhe shkolla, në *Standarde dhe identitete*. Prishtinë 159,
- Lamaj, A. (2005). Prurja dhe shqyrtimet etno-sociogjuhësore shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. "Seminari XXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare- gusht 2005". Prishtinë, 24/1, 429-437.
- Lloshi, Xh. (2001). *Gjuha shqipe standarde në rrethanat e dygjuhësisë*. Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", gusht 2001". Prishtinë, 20/1, 263-274.
- Memushaj, Rr. (1996) Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës, në *Studime albanologjike*, 1.
- Osmani, T.;Pepa,S.(1995-1996) Pasqyrimi i eufemizmeve në letërsinë gojore dhe artistike, *B.sh*. Shkodër.
- Radovanovic, M. (1979) *Sociolinguistika*. Beograd, Bigz.
- Rrokaj, Sh. (1995) Shkencat e gjuhës

- hapësirë dhe kufij, në *Revista letrare*, 3, Tiranë.
- Rrota, J. (1931). Gjuha shkon tue bam ato ndryshimet e veta. Në *"Hylli i Dritës"*, nr. 3.
- Rugova, B. (1999). Gjuha e fshehtë e të rinjve të Prishtinës, në *Seminarin XXII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 364-369, Prishtinë.
- Sejdiu, Sh. (2002) *Sisteme e struktura, raporte*, Prishtinë.
- Shamku-Shkreli, L. (2005) Për një sociolinguistikë funksionale. *Seminarin XXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, gusht 2005. Prishtinë, 24/1, 438-445.
- Shpuza, J. (1998) *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve*, Shkodër.
- Ymeri, M. (1999). Ligjërimi rinor i studentëve të viteve '90, në *Seminarin XVIII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 275-282, Tiranë.
- Zhugra, A. (2001) Rreth normave të sjelljes gjuhësore dhe kriterëve të gojtarisë, *Gjurmime albanologjike*. Prishtinë.
- Zhugra, A. (2003) *Etnolinguistika në veprën Çabejt*, UGJ.
- Shkurta, Gj. (1969). Disa shqyrtime rreth zhvillimeve e ndryshimit të të folmeve popullore në disa zona të Malësisë së Madhe. *Studime Filologjike* 4, 162.
- Shkurta, Gj. (1981). *E folmja e qytetit të Lezhës*. *Studime Filologjike* 1-3, 155-163.
- Shkurta, Gj. (1984) Shtresime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës, në *Studime Filologjike*, 2.
- Shkurta, Gj. (1996a). Nga gjeolinguistika tek dialektologjia urbane. *Studime albanologjike*, 1. Tiranë.
- Shkurta, Gj. (1996b). *Sociolinguistika*
- Shkurta, Gj. (1998a). Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Çabejt. *Eqrem Çabej personalitet i shkencës dhe kulturës shqiptare*. Shkodër. 87.
- Shkurta, Gj. (1998b) Gjuha shqipe dhe trysnia shoqërore, në *"Gjuha dhe ligjërimi në shkollë* 10, 48, Shkodër.
- Shkurta, Gj.; Memushaj, Rr. (1998c) Shkolla dhe shqipja letrare, *Gjuha jonë*, 1-4.
- Shkurta, Gj. (2000). Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës. Tiranë 5-3-4, 142.
- Shkurta, G. (2001). *Onomastikë dhe etnolinguistikë*. Tiranë, Shblu.
- Shkurta, Gj. (2002) Fjalori i rënduar i medias. Tiranë, Antena.
- Shkurta, Gj. (2003). *Sociolinguistika*. Tiranë, Shblu.
- Shkurta, Gj. (2004) *Etnografia e të folurit të shqipes*, Tiranë.